



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

RAPORT 6 - MUJOR

PËR FINANCAT VENDORE

JANAR – QERSHOR 2021

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

FINANCATLOKALE | Forcimi i Menaxhimit
LOCALFINANCES | të Financave Publike
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO

Përmbajtja

Përmbledhje e gjetjeve kryesore.....	4
Statusi Fiskal i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në fund të muajit Qershor 2021.....	8
Të dhëna për të Ardhurat Vendore.....	9
Të dhëna për Shpenzimet Vendore.....	13
Paraqitja grafike e treguesve në nivel bashkie.....	19

Përmbledhje e gjetjeve kryesore


Raporti i konsoliduar për performancën e Financave Vendore gjatë periudhës 6-mujore (Janar-Qeshor 2021) është përgatitur nga Drejtoria e Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e ekipit të projektit "Financat Lokale"¹, mbi bazën e të dhënave të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ). Në raport jepet ecuria e mbledhjes së të ardhurave vendore dhe kryerja e shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore (61 bashki dhe 12 këshilla qarku).

Në mbështetje të parashikimeve, viti 2021 shënon periudhën e rimëkëmbjes së ekonomive vendore pas presionit të fortë që ushtroi kriza e COVID-19 dhe përpjekjeve për përballimin e situatës.

Të ardhurat e veta të pushtetit vendor përbëjnë 6% të totalit të të ardhurave publike në 6 mujorin e parë të vitit 2021 **me një realizim prej 15.3 miliard lekë**, ku 91% ose 13.9 miliardë e zënë taksat dhe tarifatat vendore, dhe 1.3 miliard lekë të ardhurat jotatimore. Të ardhurat vendore paraqiten me performancë në rritje, jo vetëm krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 që i përket periudhës së mbylljes totale nga pandemia COVID-19 (36% më shumë), por **ato paraqiten me rritje edhe** në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019, **respektivisht në masën 4 %** (+ 508 milionë lekë).

Shpenzimet e pushtetit vendor gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021 janë rreth **24.3 miliard lekë** ose rreth 42% të planit vjetor të miratuar, duke **zënë rreth 9.2% të totalit të shpenzimeve publike të qeverisjes së përgjithshme**. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur me rreth **9.5%**.

Grafiku 1 paraqet ecurinë e taksave të arkëtuara nga NJVQV-të dhe shpenzimeve vendore në raport me planin vjetor.




Nga analiza e treguesve përgjithësisht vihet re që rritja kryesore e të ardhurave vjen nga grupi i **taksave të pasurisë me rreth 59% kundrejt 2020 dhe 14% më shumë kundrejt vitit 2019.**

Të grupuara sipas numrit të popullsisë, **bashkitë me mbi 100 mijë banorë** (11 bashki përfshi edhe Tiranën) kanë **realizuar 82% të totalit** të të ardhurave të veta vendore në rang vendi.

Nga pikëpamja strukturore, **3 lloje të taksave & tarifave vendore sigurojnë 71% të të ardhurave të mbledhura nga NJQV-të**, duke përbërë burimin kryesor të financimit të politikave vendore në nivel vendi (pa përfshirë këtu transfertat dhe grandet): Taksa e ndikimit në infrastrukturë me 31%, Taksa mbi Ndërtesat me 21% dhe Tarifa pastrimi e higjenes me 19% ndaj totalit të të ardhurave vendore të veta.

Grafiku 2 prezanton strukturën në % të të ardhurave vendore sipas burimit në 6M - 2021




Mbetet për tu analizuar më tej zëri “Taksa të tjera” që përbën 13% të totalit të të ardhurave vendore, një përqindje jo e vogël kjo krahasuar me llojet e tjera të taksave të detajuara në grafikun më lart.

Pavarësisht riaktivizimit të ekonomive vendore gjatë këtij gjashtëmujori, vendi vazhdon të ndodhet në kushtet e kufizimeve për shkak të pandemisë, që mund të vazhdojnë deri në fund të periudhës së vaksinimit. Kjo situatë pasqyrohet në **strukturën e shpenzimeve sipas funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore, e cila reflekton vazhdimësinë e masave për përballimin e krizës dhe pasojave të saj.**

Kjo strukturë është e ngjashme me të njëjtën periudhë të vitit 2020 (grafiku 9), por shumë e ndryshme në krahasim me aktivitetin normal në të njëjtën periudhë të vitit 2019. Vihet re në grafikun e mëposhtëm rialokimi i fondeve nga funksionet 01-Shërbimet e përgjithshme publike dhe 08- Argëtimi, kultura dhe feja, tek funksione të tjera si 06 – Strehimi, 03 – Rendi dhe siguria publike dhe 10 – Mbrojtja sociale.

Grafiku 3 paraqet peshën specifike të shpenzimeve vendore sipas funksioneve në 6 mujorin 2021 kundrejt 2019.



Shpenzimet për investime kanë pësuar një rritje të lehtë prej 16% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa investimet e **Bashkisë Tiranë përbëjnë rreth 34%** të totalit të investimeve të realizuara nga pushteti vendor gjatë kësaj periudhe.

Statusi Fiskal i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në fund të muajit Qershor 2021


Nr	EMERTIMI	30 Qershor 2020	30 Qershor 2021	Struktura (%) te Ardhurave & Shpenzimeve 2021	Ndryshimi kundrejt 2020	Plani Vjetor 2021*	% Realizimit ndaj planit
A	TE ARDHURA VENDORE	23,942	29,093	100%	21%	57,840	50%
I	Te ardhura veta	11,177	15,325	53%	37%	29,776	51%
I.1	Taksa dhe Tarifa te mbledhura ne nivel vendor	10,235	13,966	48%	36%	25,426	55%
	a. Takse mbi pasurine	2,248	3,566	12%	59%	5,648	63%
	b. Biznesi i vogel	331	292	1%	-12%	0	
	c. Taksa dhe tarifa lokale te tjera	7,657	10,108	35%	32%	19,778	51%
I.2	Te ardhura jotatimore	942	1,359	5%	44%		
II	Te ardhura nga transferta e pakushtezuar dhe sektoriale	12,642	13,500	46%	7%	28,064	48%
III	Grante te huaja	123	258	1%	110%		
B	Shpenzime Vendore	22,220	24,326	100%	9%	57,840	42%
I	Shpenzime paga dhe sigurime	11,076	11,866	49%	7%		
II	Shpenzime operative	6,086	6,753	28%	11%		
III	Subvencione, Transferta dhe financiare	765	746	3%	-2%		
IV	Shpenzime Kapitale	4,292	4,962	20%	16%		
C	Suficiti vendor	1,722	4,757		176%		

* Të dhënat e planit vjetor 2021 i referohen Aktit Normativ Nr. 26, datë 22.6.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar".

Të dhëna për të Ardhurat Vendore


- Të ardhurat e veta të pushtetit vendor në 6 mujorin e parë të vitit 2021 janë realizuar rreth **15.3 miliard lekë (51% e planit vjetor 2021)**, ku 91% ose 13.9 miliard e zënë taksat dhe tarifat vendore. Krahësuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, të ardhurat e veta vendore janë realizuar me rreth **37% më shumë** ose në vlerë absolute **4.1 miliard lekë**.

Grafiku 4 paraqet raportin e të ardhurave në taksa dhe tarifa vendore gjatë 6M- 2021/2020.



- Ndryshe nga 6 mujori i vitit të kaluar ku efekti i COVID-19 është ndjerë në treguesit e të ardhurave të veta vendore të cilat patën ulje me rreth 24% krahasuar me vitin 2019, në 6 mujorin e parë të vitit 2021 vihet re **një përmirësim i performancës së të ardhurave të veta** ku me performancën më të mirë paraqitet grupi i **taksave të pasurisë me rritje me rreth 59%** ose ndryshe me një realizim në vlerë absolute rreth **3.5 miliard lekë**, dhe pas tij vjen zëri i **taksave dhe tarifave të tjera lokale me rritje prej 32%**, ose me një realizim rreth **10 miliard lekë**.


Grafiku 5 në vijim paraqet përberjen e Grupit të Taksave mbi Pasurinë të realizuara në 6M - 2021/2020



- Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, sic është parashikuar qysh në planifikim, zëri që paraqitet me ulje është **taksa mbi biznesin e vogël me rreth 12%** ose ndryshe rreth **39 milion lekë** me pak së një vit më parë, **si pasojë e ndryshimeve ligjore**.
- Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, në totalin e taksave dhe tarifave të mbledhura nga njësitet e vetëqeverisjes vendore si burimet më të rëndësishme paraqiten **“Taksa e ndikimit në infrastrukturë”** e cila zë rreth **31%** ose një masë realizimi rreth **4.3 miliard lekë**, **“Taksa e ndërtesës”** me rreth **21%** ose ndryshe një masë realizimi **2.8 miliard lekë** dhe **“Tarifa e pastrimit dhe higjienës”** me **19%** ose ndryshe një realizim rreth **2.6 miliard lekë**.
- Nga taksat mbi pasurinë** në 6 mujorin e parë të vitit 2021, janë akumuluar gjithsej **3.5 miliard lekë** ose rreth 1.3 miliard lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Peshën më të madhe e ka zëri i **taksës mbi ndërtesën** me një realizim rreth **2.8 miliard lekë ose 80%** të totalit të të ardhurave nga taksat mbi pasurinë.

- Në raport me totalin e të ardhurave nga taksat e pasurisë, gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, zëri i **taksës së transaksioneve** të pasurive të paluajtshme të realizuar në masën **337 milion lekë** zë rreth **9% të totalit**, ndërsa zëri i **taksës mbi tokën bujqësore** është realizuar në vlerën e rreth **228 milion lekë** dhe zë 6% të totalit të taksës së pasurisë. **Zëri i taksës së truallit** realizuar me rreth **136 milion lekë** është edhe zëri që ka peshën më të vogël në taksën e pasurisë **rreth 4%**.
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë**, gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, me **4.3 miliard lekë zë 43%** të vlerës totale të “taksave të tjera lokale” (prej 10.1 miliard lekë). Nga ky burim i të ardhurave vendore krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë akumuluar rreth 589 milionë lekë më shumë të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- **60% e totalit të të ardhurave vendore** (ose 9.2 miliard lekë) **është mbledhur nga Bashkia e Tiranës** gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021. Burimi me i madh i të ardhurave për këtë bashki është “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” e cila arrin vlerën e 3.4 miliard lekë ose rreth 37% të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat, ose rreth 22% të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë.
- Të grupuara sipas numrit të popullsisë, **bashkitë me mbi 100 mijë banorë** (11 bashki përfshi edhe Tiranën) kanë **realizuar 82% të totalit** të të ardhurave të veta vendore në rang vendi.
- Duke përjashtuar Bashkinë Tiranë, **10 bashkitë me mbi 100 mijë banorë** kanë mbledhur rreth **3.3 miliard lekë ose rreth 55%** të totalit të të ardhurave vendore (për 60 bashkitë e mbetura).
- 13 bashkitë me popullsi **50-100 mijë banorë** kanë mbledhur rreth **1 miliard lekë ose 16%** të totalit të të ardhurave vendore (të 60 bashkive pa përfshirë Tiranën).
- 37 bashkitë me popullsi **nën 50 mijë banorë** kanë mbledhur **1.7 miliard lekë ose 29%** të totalit të të ardhurave të veta vendore (të 60 bashkive pa përfshire Tiranën).


Grafiku 6 prezanton përbërjen e grupit të taksave dhe tarifave të tjera lokale.



Të dhëna për Shpenzimet Vendore


- **Totali i shpenzimeve të pushtetit vendor** gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021 është rreth **24.3 miliard lekë** ose rreth **42%** të planit vjetor të miratuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet e pushtetit vendor janë realizuar rreth **9.5% më shumë** ose në vlerë absolute rreth **2 miliard lekë**.
- Në shpenzimet e realizuara në 6 mujorin e parë të vitit 2021, peshën më të madhe e zënë **shpenzimet e personelit me rreth 48.8%** e totalit të shpenzimeve vendore, pas tyre vijnë **shpenzimet operative me rreth 27.8%; shpenzime të tjera për subvencione dhe transferta me rreth 3.1%,** ndërsa **shpenzimet për investime zënë rreth 20.4%.**

Grafiku 7 në vijim paraqet strukturën e shpenzimeve vendore sipas natyrës ekonomike në 6 mujorin 2021/2020.




- **Shpenzimet për investime kanë pësuar një rritje të lehtë me rreth 669 milionë lekë ose ndryshe rreth 16%** krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- **Bashkia e Tiranës zë rreth 34%** të totalit të investimeve të realizuara nga pushteti vendor gjatë kësaj periudhe.
- **Shpenzimeve të tjera korrente** (ku përfshihen edhe transfertat familjare, subvencionet) kanë **pasur një rënie** gjatë 6 mujorit të parë 2021 me rreth 20 milionë lekë ose ndryshe me rreth 20% krahasuar me një vit më parë.
- Gjatë pandemisë COVID-19, pushteti vendor ka ndryshuar strukturën e shpenzimeve sipas burimeve duke rritur peshën e shpenzimeve të financuar nëpërmjet transfertave dhe ulur atë nga të ardhurat e veta. Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, **peshën më të madhe e zënë shpenzimet e realizuara nga transfertat nga buxheti i shtetit me rreth 55%**, ndërsa ato nga **të ardhurat e veta zënë rreth 43%, 1% shpenzimet me burim financimin e huaj dhe 0.2% shpenzimet e realizuara me burim financimi të ardhurat jashtë limitit**. Pavarësisht peshës që zënë shpenzimet sipas burimit të financimit, këtë vit kemi një kthesë ndryshe nga viti i pandemisë, përqindja që zënë shpenzimet e realizuara nga transfertat ndaj shpenzimeve totale të realizuara është ulur me 2%, ndërsa ajo nga të ardhurat e veta është rrit me 1%.

Grafiku 8 prezanton strukturën e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas burimit të financimit për 6 mujorin 2021/2020.



- **Për Bashkinë Tiranë, 20%** e shpenzimeve janë financuar nga **transfertat** e buxhetit qendror dhe **78% nga të ardhurat e veta** si dhe 2% financim i huaj.
- Në 6 mujorin e parë të vitit 2021, konstatohet rritje të shpenzimeve në funksionet si “Rendi dhe Siguria”, “Çështjet Ekonomike”, “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”, “Mbrojtja e mjedisit”, “Arsimi”, “Argëtimi kultura dhe feja”, dhe “Mbrojtja sociale” në vlerën totale prej **rreth 2.2 miliard lekë** më shumë se një vit më parë.


Grafiku 9: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas funksioneve në 6 mujorin 2021/2020.




- **Funksi "Shërbimet e përgjithshme publike"** ka rritjen më të madhe të shpenzimeve gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, krahasuar me një vit më parë me rreth **741 milion lekë ose 14% më shumë**, dhe më pas vjen "Strehimi dhe komoditetet e komunitetit" me rritje me rreth 19%.
- Krahasuar më të njëjtën periudhë të një viti më parë **funksi qe paraqiten me financim me ulje** janë "Shëndetësia" me rënie me rreth 30% si dhe "Rendi dhe siguria publike" me rreth 7%.
- Bashkia Tiranë, në 6 mujorin e parë të vitit 2021 ka realizuar rreth **29% të totalit** të shpenzimeve të pushtetit vendor **me një vlerë 7 miliard lekë**, ndërkohë që shpenzimet për investime të kësaj bashkie **zënë 34%** të totalit të investimeve të realizuara nga pushteti vendor gjatë kësaj periudhe.

- Të grupuara sipas popullsisë në 6 mujorin e parë të viti 2021, duke përfshirë Bashkinë Tiranë, **10 bashkitë me mbi 100 mijë banorë** kanë realizuar rreth **6.5 miliard lekë ose 44%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor (60 bashki pa Tiranën),
- 13 bashkitë me një popullsi **ndërmjet 50 -100 mijë banorë** kanë realizuar rreth **3.3 miliard lekë shpenzime ose 23%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor (60 bashki, pa Tiranën) dhe pjesa tjetër prej 37 bashkive që kanë popullsi **nën 50 mijë banorë** kanë realizuar **rreth 4.9 miliard lekë shpenzime ose ndryshe 33%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.

Grafiku 10 paraqet shpenzimet sipas funksioneve vendore dhe burimeve të financimit në 6 mujorin 2021




Grafiku 11 jep krahasimin në pikë përqindje midis gjashtëmujeve 2021 - 2020 lidhur me shpenzimet sipas funksioneve vendore dhe burimeve të financimit të tyre.




Paraqitja grafike e treguesve në nivel bashkie


Grafiku 12: Përqindja e të ardhurave sipas bashkive ndaj totalit të ardhurave vendore 6M 2021



Grafiku 13: Përqindja e të ardhurave të secilës bashkie ndaj totalit të të ardhurave vendore pa bashkinë Tiranë për 6 mujorin 2021



Grafiku 14: Ndryshimi i të ardhurave vendore sipas bashkive në 6 mujorin 2021/2020.



Grafiku 15: Ndryshimi i shpenzimeve vendore sipas bashkive në 6 mujorin 2021/2020.

